



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 33 regjistër (JR)  
Datë 15.07.2019

Nr. 33 i vendimit  
Datë 24.11.2020

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Relator</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 24.11.2020, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 33/2019 (JR), datë 15.07.2019, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Dritan Seci, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 114, datë 11.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Seci.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni 42 i Kushtetutës, neni F i Aneksit të Kushtetutës, nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi shkaqet e

ankimit të subjektit të rivlerësimit, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Ardian Hajdari, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Dritan Seci (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar funksionin e gjyqtarit/kryetarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Më parë, në funksion të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
  - (i) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
  - (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
  - (iii) ka kryer fshehje të pasurisë;
  - (iv) ka kryer deklarim të rremë;
  - (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, më pas ka dërguar një raport të arsyetuar, duke konkluduar mbi “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Seci”.
5. Grupi i Punës në Inspektoratin pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, më pas ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Grupi i Punës i Prokurorisë së Përgjithshme, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit (vlerësimin e

pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale) dhe mori vendimin objekt shqyrtimi nr. 114, datë 11.03.2019.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

7. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, bazuar në nenin 179/b, në pikat 1, 3 e 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të pikës 1/c dhe pikës 3 të nenit 58 dhe të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Seci, me funksion kryetar/gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.*
8. Ky vendim është marrë në vijim të konkluzioneve të mëposhtme për secilin prej kritereve të vlerësuar.

**8.1.** Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit: a. ka kryer fshehje të pasurisë, deklaram të rremë, deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë të pasurisë; b. nga analiza financiare, rezulton se për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012, subjekti, me të ardhurat e fituara nga punësimi tij dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomiko-financiare e bashkëshortes, kreditë e dhuratat, nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara. Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit Dritan Seci nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

**8.2.** Në lidhje me kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, kreu V të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Dritan Seci, është i përshtatshëm për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.

**8.3** Lidhur me vlerësimin e aftësisë profesionale, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, kreu VI të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

## **III. Shkaqet e ankimit**

9. Më datë 26.06.2019, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë pranë Komisionit ankimin ndaj vendimit nr. 114, datë 11.03.2019, me të cilin është njoftuar, në formën e shkruar të tij, më datë 14.06.2019. Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor sipas nenit<sup>1</sup> 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në konkluzion të ankimit të tij, subjekti i rivlerësimit kërkoi që shkaqet e ankimit t'i marrë në shqyrtim Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe, në përfundim, kërkoi:

---

<sup>1</sup> Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apeliteve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

**9.1** Kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 114, datë 11.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Dritan Seci.

**9.2** Ndryshimin e vendimit nr. 114, datë 11.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Dritan Seci, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

### **Shkaqet procedurale të ankimit**

**9.3** Lidhur me kërkimet me natyrë procedurale, subjekti i rivlerësimit kërkon nëpërmjet ankimit, kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 114, datë 11.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**9.4** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Kushtetuta, pas ndryshimeve përkatëse, parashikon se nëse subjekti i rivlerësimit ka pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai shkarkohet nga detyra, si dhe nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim. Edhe sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, barra e provës kalohet kur provohen dyfishi i pasurisë dhe jo për rastin kur kemi të bëjmë me pasuri që nuk janë të subjektit të rivlerësimit.

**9.5** Subjekti i rivlerësimit pretendon se i gjithë procesi i hetimit dhe i vendimmarrjes ka qenë në kundërshtim flagrant me nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit pretendon gjithashtu se në përcaktimet e nenit Ç, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, është parashikuar se organet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve garantojnë respektimin e parimit për një proces të rregullt. Komisioni ka shkëlur parimin e kontradiktoritetit dhe parimin e barazisë së armëve në proces. Në bazë të nenit A të Aneksit të Kushtetutës, nuk parashikohet si kufizim i shprehur e drejta për një proces të rregullt e të drejtë, ndaj për vlerësimin e pasurisë subjekti i rivlerësimit pretendon se vetëm për proces të rregullt ligjor nuk mund të flitet në këtë rast.

### **Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë**

**9.6** Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen {\*\*\*}, Bajram Curri, Tropojë, blerë me kontratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 11.08.2012, me vlerë 2200000 lekë, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzionet e Komisionit në lidhje me arredimin e shtëpisë janë të njëanshme dhe e penalizojnë padrejtësisht. Subjekti i rivlerësimit pretendon se e ka sqaruar disa herë se e gjithë vlera e arredimit të shtëpisë së tij ndër vite është 1000000 lekë dhe logjika e Komisionit se, meqë nuk ka fatura për pajisjet, këto duhet të ndahen në vlerën nga 500000 lekë në vitet 2012 dhe 2013, është absurde.

**9.7** Subjekti i rivlerësimit pretendon se lidhur me konstatimin e Komisionit se subjekti nuk ka deklaruar gjendjen *cash* për periudhën 2008 – 2012, ka dhënë sqarime si në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ashtu edhe në seancë dëgjimore, sqarime të cilat kanë qenë

bindëse përtej dyshimeve të Komisionit, lidhur më shkaqet që kanë çuar në pasaktësitë në plotësimin e formularëve të deklarimit.

**9.8 Lidhur me ambientin e shërbimit me sip. 40 m<sup>2</sup>**, i marrë me qira nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, me adresë rr. {\*\*\*}, B. Curri, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është absurd dhe i mbështetur në hamendësime. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka marrë parasysh shpjegimet e tij dhe deklaratat noteriale të lëshuara nga qiradhënësi. Ai pretendon se çmimet e qirave i përcakton kërkesë-oferta dhe përsëritja në heshtje e një kontrate qiraje nuk është një veprim i ndaluar nga ligji dhe Kodi Civil, i cili e njeh miratimin në heshtje të një veprimi juridik. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni, në mënyrë kontradiktore, nuk ka pranuar shpjegimet dhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të thirrur si dëshmitarë qiradhënësit.

**9.9 Lidhur me të ardhurat nga aktiviteti i farmacisë së bashkëshortes**, subjekti i rivlerësimit pretendon se KPK-ja ka kryer një krahasim të gabuar ndërmjet të ardhurave që vetëdeklarohen në fillim të vitit nga tatimpaguesi me të ardhurat e pasqyruara në deklaratat e bilancit ndër vite. Sipas subjektit të rivlerësimit, tatimi paguhet mbi fitimin e llogaritur sipas deklaratës së bilancit dhe jo sipas parashikimeve që bëhen në fillim të çdo viti. Sipas subjektit të rivlerësimit, bashkëshortja për vitet 2009 dhe 2010 ka qenë e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin sepse ka pasur qarkullim më të vogël se 5.000.000 lekë.

**9.10** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka kryer një gabim aritmetik dhe logjik në lidhje me gjendjen e likuiditeteve në fund të çdo viti, pasi është marrë si gjendje pasurore edhe llogaria e biznesit të bashkëshortes. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo është e gabuar sepse kjo llogari ka shërbyer për nevojat dhe likuidimet e biznesit. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në deklaratimet e tij periodike, likuiditetet janë deklaruar pa llogarinë e bashkëshortes.

**9.11** Subjekti i rivlerësimit pretendon se bashkëshortja e tij e ka hapur biznesin në vitin 2009, vit në të cilin ka deklaruar 2.000.000 lekë. I gjithë qarkullimi përbëhet nga shitja e ilaçeve dhe rimbursimi prej 1.266.638 lekësh është kryer në vitin 2009, ndërsa vlera prej 733.362 lekësh është rimbursuar në vitin 2010, së bashku me një paradhënie që i është dhënë, prej 400.000 lekësh, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor (në vijim “DRSKSh”).

**9.12 Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup>**, me adresë: Rruga {\*\*\*}, {\*\*\*}, Tiranë, porositur nga subjekti i rivlerësimit me kontratën e porosisë të datës 26.04.2008, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit, si dhe deklaratën noteriale të pronarit të shoqërisë {\*\*\*}. Kjo pasuri është në pronësi të një personi tjetër dhe ky është një fakt i verifikueshëm nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Sipas subjektit të rivlerësimit, ai ka lidhur një kontratë porosie më datë 26.04.2008 për këtë apartament, për të cilin është paguar si kapar shuma prej 4.000 eurosh dhe, sipas kontratës, likuidimi i plotë i shumës do të bëhej në datën 15.05.2018.

Sipas subjektit të rivlerësimit, likuidimi i kësaj shume nuk është bërë asnjëherë dhe ky apartament nuk ka kaluar asnjëherë në pronësinë e tij.

**9.13 Në lidhje me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 11.03.2014, të shtetasit B. M,** subjekti i rivlerësimit pretendon se me këtë shtetas nuk ka asnjë njohje dhe asnjë kontakt. Deklarata e bërë nga ana e tij është e njëanshme dhe nuk provon në asnjë situatë marrjen nga ai shumën e pretenduar në këtë deklaratë. Sipas kësaj logjike, çdokush mund të bëjë një deklaratë të tillë dhe mund të vendosë çdo lloj shume, por kjo kurrsesi nuk mund të provojë faktin se diçka e tillë ka ndodhur vërtet. Që kjo marrëdhënie e pretenduar nga shtetasi në fjalë, të ketë vlerë ligjore, subjekti i rivlerësimit pretendon se do të duhej që ta pranonte një dhuratë të tillë nga ky shtetas, pasi dhe vetë Kodi Civil, neni 761, e ka përcaktuar se në marrëdhënien juridike të dhurimit, pala tjetër duhet të shprehet se e pranon dhuratën. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk e ka pranuar këtë marrëdhënie juridike dhe as e njuh shtetasin deklarues dhe se po shqyrton mundësinë e një kallëzimi penal apo padie civile për shpifje, pasi deklaratimet janë krejtësisht të pavërteta.

**9.14 Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 74 m<sup>2</sup>, ndodhur në Bajram Curri, pasuri në bashkëpronësi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me prindërit e saj,** subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se kjo pasuri është blerë nga prindërit e bashkëshortes kur subjekti ende nuk ishte martuar me të dhe se bashkëshortja e tij nuk ka pasur dijeni se është bashkëpronare e nuk e ka informuar subjektin në lidhje me këtë fakt. Pasi janë informuar nga prindërit e bashkëshortes, në deklaratën noteriale të datës 06.09.2018, bashkëshortja ka hequr dorë nga bashkëpronësia e kësaj pasurie dhe për këtë janë kryer edhe ndryshimet përkatëse në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Bajram Curri.

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit**

##### *A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegji*

##### *i. Juridiksioni i Kolegjit*

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

##### *ii. Legjitimimi i ankuesit*

11. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe

*ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

12. Në përputhje me nenin<sup>2</sup> 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 114, datë 11.03.2019, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Dritan Seci, u mor në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

12.1 Kolegji shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen me cilësinë e provave të reja të akteve të cilat janë përcjellë në Kolegj me depozitimin e parashtrimeve, më datë 18.11.2020, si dhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit të pretenduar në ankim, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. Provat të cilat subjekti ua ka bashkëngjitur parashtrimeve janë si në vijim.

1. Shkresë nr. {\*\*\*}prot., datë 13.11.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tropojë.
2. Kallëzim penal ndaj shtetasit B. M.
3. Praktika e regjistrimit të pasurisë së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në bashkëpronësi me prindërit e saj, nga momenti i blerjes në vitin 2002, deri në regjistrimin e fundit të vitit 2018, pas heqjes dorë nga pasuria e paluajtshme nga ana e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

Nga provat e paraqitura bashkëlidhur parashtrimeve, rezulton se praktika e regjistrimit të pasurisë së bashkëshortes në bashkëpronësi me prindërit e saj, është dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës në Komision. Ndërsa pjesa tjetër e provave që lidhen me kallëzimin penal të ngritur nga subjekti i rivlerësimit, janë prova të reja të cilat nuk i ka paraqitur më parë.

12.2 Analiza e pranueshmërisë për shqyrtim ose jo të këtyre provave, lidhet me zbatimin e normave ligjore që rregullojnë situatën në fjalë. Kolegji e mbështeti vendimin e tij në këtë rast në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit parashikohet: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj, dispozitë kjo e detyrueshme për zbatim, në referim të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, bazuar edhe në nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: *Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit.* Për më tepër, në nenin 49 të ligjit nr. 49/2012, parashikohet vetëm e drejta e paraqitjes deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes të*

---

<sup>2</sup> “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51, dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

parashtrimeve me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim, por nuk parashikohet mundësia e paraqitjes së provave të reja.

**12.3** Në verifikim të këtyre parashikimeve ligjore, në rastin konkret, vlerësohet se provat e paraqitura prej subjektit të rivlerësimit bashkëlidhur parashtrimeve, nuk mbështeteshin mbi fakte që provonin mospasjen mundësi të paraqitjes së tyre që në fazën e hetimit administrativ në Komision, siç kërkon zbatimi i nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, për rrjedhje u konsideruan si të panevojshme në kuptim të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe si të tilla që, edhe sikur të konsideroheshin me vlera të plota provuese në drejtim të fakteve që subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë nëpërmjet tyre, përsëri ato nuk mund të ndikojnë në marrjen e vendimit, në kuptim të nenit 49, pika 6, germa “d” e ligjit nr. 49/2012, cituar më lart.

**12.4** Në përputhje me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, gjykimi në apel, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi. Nuk rezultoi i nevojshëm shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore publike për t’i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit për t’u dëgjuar edhe në Kolegj. Kjo edhe për faktin se kërkimi që paraqet subjekti i rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë publike nuk parashikohet në rastet specifike ligjore, sipas kërkesave të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Gjithashtu, Kolegji kryesisht vlerësoi se: a) konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; b) nuk konstatoi shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuar gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; c) nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision.

**12.5** Kolegji, pasi e gjeti të pabazuar në ligj kërkimin e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, siç u përshkrua më sipër, dhe duke qenë se as vetë kryesisht nuk konstatoi ekzistencën e ndonjë prej kushteve të parashikuara prej nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon rastet se kur një gjykim administrativ në Gjykatën e Apelit zhvillohet në seancë gjyqësore publike, vendosi ta shqyrtojë çështjen në formën e gjykimit në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

## ***B. Mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit***

### **Analizimi i shkaqeve procedurale të ankimit**

- 13.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Kushtetuta, pas ndryshimeve përkatëse, parashikon se nëse subjekti ka pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai shkarkohet nga detyra, si dhe nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim. Kushtetuta në nenin D të Aneksit të saj kërkon që subjekti i rivlerësimit të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme që të prezumohet marrja e masës disiplinore sipas parashikimeve ligjore. Edhe sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, barra e provës kalohet kur provohen dyfishi i pasurisë dhe jo për rastin kur kemi të bëjmë me pasuri që nuk janë të subjektit të rivlerësimit.

**13.1** Kolegji vëren se Komisioni nuk e ka bazuar vendimin në nenin 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon dhënien e masës disiplinore në rastet kur rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, për pasojë pretendimi i subjektit të rivlerësimit për zbatim të gabuar të kësaj dispozite, nuk gjendet i bazuar dhe relevant



në rastin konkret. Në këtë proces, subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin<sup>3</sup> D të Aneksit të Kushtetutës, i duhet por jo vetëm, të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Barra e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, në këtë proces i kalohet subjektit të rivlerësimit jo vetëm kur provohet dyfishi i pasurisë, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, por edhe për çdo element tjetër të parashikuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, në funksion të verifikimit të pasurisë së subjekteve të rivlerësimit dhe të personave të lidhur. Tashmë është krijuar jurisprudenca në Kolegj në lidhje me faktin e kalimit të barrës së provës subjekteve të rivlerësimit jo vetëm për dyfishin i pasurisë së ligjshme, por për çdo element kontrolli të pasurisë me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

14. Në lidhje me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit pretendon se i gjithë procesi i hetimit dhe vendimmarrjes ka qenë në kundërshtim flagrant me nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit pretendon gjithashtu se përcaktimet e nenit Ç, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës kanë parashikuar se organet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve garantojnë respektimin e parimit për një proces të rregullt, duke shkelur kështu parimin e kontradiktoritetit dhe parimin e barazisë së armëve në proces. Në bazë të nenit A të Aneksit të Kushtetutës, nuk parashikohet si kufizim i shprehur e drejta për një proces të rregullt e të drejtë, ndaj për vlerësimin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit pretendon se vetëm për proces të rregullt ligjor nuk mund të flitet në këtë rast.

14.1 Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka shkelur parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve, Kolegjit, në analizë të akteve të administruara në fashikull, i rezulton që Komisioni, gjatë kryerjes së hetimit administrativ, ka pasur komunikim të vazhdueshëm me subjektin, gjithashtu në zbatim të parashikimeve ligjore të nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 45 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, subjektit të rivlerësimit i janë bërë me dije rezultatet paraprake të hetimit, i është vënë në dispozicion, me qëllim ushtrimin e mbrojtjes efektive dhe të plotë, e gjithë dosja hetimore e krijuar dhe i është lënë një afat i arsyeshëm për paraqitjen e shpjegimeve, prapësimeve dhe provave. Në korrespondencën e tij, Komisioni i bën qartësisht me dije subjektit të rivlerësimit të

---

<sup>3</sup> “1-Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

2-Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklaramit, sipas ligjit.

3-Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.

4-Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën.

5-Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.”

drejtat që gëzon në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarëve, si dhe afatin brenda të cilit mund të ushtrojë këto të drejta në zbatim të parimit të barazisë së armëve. Gjithashtu, nga procesverbali i seancës dëgjimore, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka prezantuar fjalën e tij, përgjatë së cilës ka shpjeguar vlerësimin e tij për të gjitha rezultatet e hetimit paraprak dhe më pas i është nënshtruar edhe procesit të një sërë pyetjesh nga Komisioni, duke ezauruar çdo mundësi të parashikuar nga ligji për të garantuar të drejtën e tij për t'u dëgjuar dhe mbrojtur.

**14.2** Kolegji vëren gjithashtu se, referuar akteve të administruara në fashikull, konstatohet se subjekti i rivlerësimit u njoftua më datë 25.02.2019, mbi përbërjen e trupit gjykues, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo për të kërkuar marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Pasi ka kryer një vlerësim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për thirrjen e dëshmitarëve, Komisioni është shprehur me të drejtë në vendim për refuzimin e kërkesës për thirrjen dhe pyetjen e disa dëshmitarëve, duke argumentuar se refuzimi është bërë me arsyetimin se fakti që kërkohej të provohej nëpërmjet dëshmisë së tyre, ishte i parëndësishëm/panevojshëm për vendimmarrjen e Komisionit.

**14.3** Neni 42, pika 2 e Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se: *Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj* (dispozitë kjo në harmoni me KEDNj-në), dispozitë e cila nuk rezulton të jetë shkelur nga Komisioni në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Dritan Seci. *Sa më sipër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për këtë shkak ankimi nuk janë të bazuara dhe të argumentuara.*

### ***Analizimi i shkaqeve që lidhen me vlerësimin e kriterit të pasurisë***

- 15. Lidhur me arredimin e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>,** ndodhur në lagjen {\*\*\*}, Bajram Curri Tropojë, blerë me kontratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 11.08.2012, me vlerë 2.200.000 lekë, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzionet e Komisionit në lidhje me arredimin e shtëpisë janë të njëanshme dhe e penalizojnë padrejtësisht. Subjekti i rivlerësimit pretendon se e ka sqaruar disa herë se e gjithë vlera e arredimit të shtëpisë së tij ndër vite, është 1.000.000 lekë dhe logjika e Komisionit është absurde kur arsyeton se, meqë nuk ka fatura për pajisjet, këto duhet të ndahen në vlerën nga 500.000 lekë në vitet 2012 dhe 2013.

**15.1.** Në funksion të shkakut të ankimit të mësipërm, Kolegji arsyeton dhe vëren se në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë: “Apartament banimi me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen {\*\*\*}, Bajram Curri, Tropojë. I regjistruar në zonën kadastrale {\*\*\*}, vol. {\*\*\*}, faqe {\*\*\*}, me nr. pasurie {\*\*\*}. Është blerë më datë 11.8.2012, sipas kontratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., me vlerë 2.200.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kursime nga paga sipas tabelës së pagave bashkëlidhur deklaratës, paga si gjyqtar 2004 – 2012, në shumën 11.562.985 lekë”.

**15.2** Në deklaratën e interesave privatë periodikë (në vijim “DIPP”) të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Blerë apartament me sip. 75 m<sup>2</sup> në Bajram Curri, me të ardhura të siguruara nga pagat, me vlerë 2.100.000 lekë, me pjesë takuese 50%”.

**15.3** Lidhur me arredimin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit i pyetur nga Komisioni në pyetësorin nr. 1, datë 04.05.2018, ka sqaruar se: [...] *arredimi i banesës është bërë ndër vite dhe gjatë pesë viteve të fundit nuk kam pasur raste arredimi apo blerje të orendive që kalojnë shumën 2500 euro. Pajisjet shtëpiake, elektrike apo dhe elektronike janë ndërruar gjatë viteve disa prej tyre për shkak të defektit apo amortizimit, por jo njëherësh, dhe në vlera shumë më të vogla se shuma 2500 euro. Shpenzimet për rikonstruksionin e apartamentit në B. Curri, arredimin, mobilimin e tij, gjatë kësaj periudhe mund të kenë shkuar 1.000.000 lekë ndër vite. Ndërsa në shpjegimet pas njohjes me rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se arsyeja se përse nuk i ka specifikuar këto shpenzime, është se këto janë bërë vit pas viti dhe në asnjë rast nuk e kanë kaluar shumën e 300.000 lekëve, për të cilën ka pasur detyrim ligjor për deklarim.*

**15.4** Nga analiza financiare e zhvilluar në Kolegj në funksion të shkaqeve të ankimit, për të qenë sa më shumë garantistë, meqenëse subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i qartë në shpjegimet e tij, është kryer një përpjesëtim në 5 vite i shpenzimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për mobilim në vlerën 1.000.000 lekë. Në analizën që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur për vitin 2012, vërehet se pavarësisht reklamimit të këtyre shpenzimeve si jo të sakta, në llogaritjen e tij, ka vendosur pikërisht vlerën 500.000 lekë si shpenzime mobilimi.

**15.5** Kolegji konstaton se Komisioni, nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit nuk ka specifikuar në mënyrë të saktë ndarjen e shumës së shpenzuar për mobilim, ndër vite, për më tepër dhe të pashoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor, duke marrë në konsideratë blerjen e këtij apartamenti, më datë 11.08.2012, vlerën e mobilimit e ka ndarë në mënyrë të barabartë në vitet 2012 dhe 2013. Në vijim Komisioni, duke i konsideruar dy vitet e para si periudhën kohore kur normalisht kryhen investimet bazike, siç janë ato në rikonstruksion dhe arredim, për të siguruar një jetesë normale, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur të ardhura financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e apartamentit në vitin 2012 në Bajram Curri dhe për të përballuar shpenzimet e kryera përgjatë këtij viti, me një balancë financiare negative prej 557.818 lekësh. Kjo analizë e Komisionit, në vlerësim të Kolegjit, nuk rezultoi objektive dhe garantiste edhe pse subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë shterues në shpjegimet e tij.

**15.6** Në analizën financiare që ka paraqitur vetë subjekti i rivlerësimit në ankim për vitin 2012, nuk e akumulon gjendjen e *cash*-it vit pas viti, edhe pse ka deklaruar shtim të tij në deklaratimet periodike. Komisioni ka kryer analizën duke e akumuluar *cash*-in, bazuar edhe në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit. Në analizën e bërë në Kolegj, gjendja e *cash*-it është analizuar duke u bazuar në deklaratimin e subjektit të rivlerësimit, njësoj si Komisioni, por është analizuar gjithashtu edhe mundësia e krijimit të gjendjes *cash*. Si rrjedhojë e analizës financiare, edhe pas përpjesëtimit të vlerës së shpenzimeve të mobilimit në 5 vite, përsëri subjekti i rivlerësimit rezulton me një diferencë negative në vlerën 252.943,77 lekë për përballimin shpenzimeve, kursimeve dhe krijimin e pasurisë për vitin 2012.

*Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit në lidhje me apartamentin e banimit me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>, Kolegjit i rezulton se subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar mobilimin e apartamentit të banimit në vitin 2012, edhe nëse shuma e shpenzuar për mobilim përpjesëtohet në pesë vite.*

16. *Lidhur me ambientin e shërbimit me sip. 40 m<sup>2</sup>, të marrë me qira nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit*, me adresë: rr. {\*\*\*}, B. Curri, ku ka ushtruar aktivitetin e farmacistes, subjekti i rivlerësimit pretendon se ky konkluzion i Komisionit është absurd dhe i mbështetur në hamendësime. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka marrë parasysh shpjegimet e tij dhe deklaratat noteriale të lëshuara nga qiradhënësi. Subjekti i rivlerësimit pretendon se çmimet e qirave i përcakton kërkesë-oferta dhe përtëritja në heshtje e një kontrate qiraje nuk është një veprim i ndaluar nga ligji dhe Kodi Civil, i cili e njeh miratimin në heshtje të një veprimi juridik. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni në mënyrë kontradiktore nuk ka pranuar shpjegimet dhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të thirrur si dëshmitarë qiradhënësi.

16.1. Kolegji vëren se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka ushtruar aktivitetin e saj në një ambient të marrë me qira shtetasit A. Gj, referuar kontratave të qirasë të depozituara nga vetë subjekti si më poshtë vijojnë.

- Kontratë qiraje nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 21.04.2009, me afat 2-vjeçar dhe pagesë 7000 lekë në muaj, me sipërfaqe 40 m<sup>2</sup>.

- Kontratë qiraje nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 03.01.2014, me afat 1-vjeçar dhe pagesë 20000 lekë në muaj, me sipërfaqe 40 m<sup>2</sup>.

- Kontratë qiraje nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 01.03.2016, me afat 1-vjeçar dhe pagesë mujore 5000 lekë në muaj, me sipërfaqe 40 m<sup>2</sup>.

16.2 Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime dhe të provojë me dokumentacion se përse mbetet e pambuluar me kontratë qiraje periudha 21.04.2011 deri në 01.01.2014, si dhe periudha 03.01.2015 deri në 01.03.2016; të japë shpjegime se në cilin vend është ushtruar aktiviteti privat "Farmaci" gjatë kësaj periudhe të pambuluar me kontratë; të shpjegojë se për cilën arsye i njëjti qiradhënësi, për të njëjtin ambient, me të njëjtën sipërfaqe, dhe me të njëjtën adresë, në të tria kontratat që subjekti i rivlerësimit ka depozituar, ka aplikuar çmime të ndryshme (7000 lekë, 20000 lekë dhe 5000 lekë). Lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, si edhe në përgjigjet e mëparshme, se kontrata për periudhën në fjalë është ripërsëritur në heshtje dhe nuk ka pasur ndryshim çmimi, i cili ka qenë po ai i kontratës së mëparshme. Edhe për periudhën 03.01.2015 deri 01.03.2016 kontrata është rinovuar në heshtje. Bashkëngjitur këtyre shpjegimeve, ka dërguar edhe deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., të datës 28.02.2019, ku qiradhënësi konfirmon deklaratimet e subjektit të rivlerësimit.

16.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. 4 të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *Në fillim është nënshkruar kontrata e qirasë në datën 21.04.2009, me afat 2-vjeçar, duke përcaktuar si qira mujore 7000 lekë në muaj. Pas përfundimit të këtij afati, nuk është nënshkruar formalisht një kontratë tjetër qiraje, por afati i saj është zgjatur në heshtje dhe bashkëshortja ime ka vijuar aktivitetin tregtar po në këtë ambient. Qiradhënësi A. Gj nuk jeton në Bajram Curri, dhe gjatë periudhës 2011 deri në vitin 2014 nuk është paguar rregullisht vlera e qirasë për këtë ambient. Me nënshkrimin e kontratës në vitin 2014, afati i së cilës fillon më datë 01.01.2014, është rënë dakord mes palëve që çmimi në kontratë të ishte 20.000 lekë për të paguar kështu edhe vlerën e qirasë së mbetur pa paguar për periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2014. Kjo marrëdhënie ka vijuar deri në vitin 2016 duke u zgjatur afati i kontratës në heshtje nga të dyja palët, pas datës 01.01.2015. Duke qenë se ambienti i porositur me kontratën e sipërmarrjes për një ambient me sipërfaqe 81,8 m<sup>2</sup> me shoqërinë {\*\*\*} ShPK nuk kishte mbaruar, është nënshkruar përsëri kontratë qiraje me afat njëvjeçar në vitin 2016 me një vlerë 5000 lekë në muaj, pasi personi fizik*

D. A (S.) ishte në pritje të transferimit të aktivitetit të saj në ambientin e porositur dhe për të cilin kishte bërë edhe pagesën e këstit të fundit në dhjetor të vitit 2015. Në lidhje me ndryshimin e çmimit, subjekti i rivlerësimit sqaron se [...] në vitin 2014 pati një rritje çmimi nga ana e qiradhënësit dhe ne e kishim të pamundur të gjenim ambient tjetër, ndërsa në vitin 2016 ishte në përfundim ambienti i porositur sipas kontratës me shoqërinë {\*\*\*} ShPK, dhe në këto kushte bashkëshortja ime i ka kërkuar qiradhënësit që nëse donte të vazhdonte kontrata e qirasë, të vazhdonte me çmimin e dakordësuar në kontratë. Duke qenë se qiraja që paguaja sipas kontratës së vitit 2016, ishte me vlerë të ulët, gjatë kësaj kohe jam marrë me përshtatjen e ambientit sipas kushteve ligjore që kërkon licencimi i farmacive, si dhe arredimin e këtij ambientit të ri. Pas plotësimit të këtyre kushteve ne dolëm në ambientin e ri.

16.4 Kolegji vëren se, sipas dokumenteve të administruara në dosje dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, rezulton se bashkëshortja e tij ka filluar të ushtrojë këtë aktivitet si farmacistë në vitin 2009. Nga viti 2009 deri në vitin 2016, periudhë për të cilën kemi të dhëna, rezulton të ketë marrë një ambient me qira me sip. 40 m<sup>2</sup>, që i përket qiradhënësit A. Gj. Në disa periudha kohore (2011-2013, 2015-2016), siç është cituar më lart, rezulton pa kontratë qiraje, periudha për të cilat subjekti i rivlerësimit pretendon se kontrata është rinovuar në heshtje. Sipas nenit 803, paragrafi i 4-t i Kodit Civil parashikohet: *Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë.* Në kontratën nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 21.04.2009, është parashikuar afati i kohëzgjatjes për një periudhë 2-vjeçare duke filluar nga data 21.04.2009, me të drejtë ripërsëritjeje. Në nenin 821 të Kodit Civil, për përsëritjen e kontratës së qirasë parashikohet: *Qiraja përtërihet në qoftë se, pasi të ketë mbaruar afati i saj, qiramarrësit i lihet në përdorim sendi i dhënë me qira pa kundërshtimin e qiradhënësit. Qiraja e re rregullohet me të njëjtat kushte si e mëparshmeja, por kohëzgjatja e saj caktohet si për qiratë me afat të caktuar.* Si rrjedhojë, Kolegji vlerësoi se palët që kanë lidhur kontratën (bashkëshortja e subjektit dhe qiradhënësi), për sa kohë nuk kanë pasur pretendime për ndërprerjen e marrëdhënies së qirasë, e kanë konsideruar kontratën të përtëritur në heshtje.

16.5 Lidhur me periudhat e ushtrimit të aktivitetit të farmacisë në ambientin e shërbimit me sip. 40 m<sup>2</sup>, të pambuluara me kontratë qiraje, rezultoi se sipas shpjegimeve dhe përgjigjeve të pyetësorëve që ka dhënë subjekti i rivlerësimit, mbeten në nivel deklarativ, megjithëse rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka ushtruar aktivitetin privat edhe gjatë periudhave të cilat rezultojnë të pakontraktuara me qira duke i konsideruar kontratat me afat të përfunduar, të përtëritura. Kolegji pranon se ligji e njeh në disa raste specifike miratimin në heshtje të përtëritjes/kryerjes së një veprimi juridik jo vetëm si në këtë rast, sipas nenit 821 të Kodit Civil, por edhe sipas parashikimeve të nenit 80 të Kodit Civil (referoju paragrafit 21.10 të këtij vendimi). Duke pasur parasysh faktin se kontratat janë përtëritur në heshtje sipas kushteve të tyre, problematikat e kësaj çështjeje që janë konstatuar gabimisht nga Komisioni, nuk mund të renditen në grupin e pasaktësive me pasojë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në këtë rast, duke i bërë këto të dhëna/fakte jorelevante për t'u kualifikuar dhe konsideruar në nivelin dhe llojin e marrjes së një mase disiplinore për subjektin e rivlerësimit.

17. ***Lidhur me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, si dhe të bashkëshortes së tij nga aktiviteti "Farmaci"***, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka kryer një krahasim të gabuar ndërmjet të ardhurave që vetëdeklarohen në fillim të vitit nga tatimpaguesi me të ardhurat e pasqyruara në deklaratat e bilancit ndër vite. Sipas subjektit të rivlerësimit, tatimi paguhet mbi fitimin e llogaritur sipas deklaratës së bilancit dhe jo sipas parashikimeve që bëhen në fillim të

çdo viti. Sipas tij, bashkëshortja për vitet 2009 dhe 2010 ka qenë e regjistruar me përgjegjësinë tatimore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin sepse ka pasur qarkullim më të vogël se 5.000.000 lekë.

**17.1** Nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, rezultojnë se në disa vite ai ka deklaruar xhiron e aktivitetit të farmacistë dhe jo fitimin nga ky aktivitet privat i bashkëshortes, përkatësisht për vitet 2009 dhe 2010.

Në dosjen e administruar në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumente përkatëse për aktivitetin e biznesit farmaci të bashkëshortes për vitet 2009 dhe 2010. Për të përlllogaritur fitimin e secilit vit, Komisioni dhe Kolegji janë bazuar në deklaratën *vetting* të subjektit të rivlerësimit për të nxjerrë fitimin e këtyre viteve, ku subjekti i rivlerësimit ka përcaktuar një fitim për secilin vit. Edhe duke u bazuar në deklaratimin e subjektit të rivlerësimit për fitimin nga aktiviteti privat i bashkëshortes, përsëri situata financiare e tij mbetet negative dhe, si rrjedhojë, shkak i ankimit i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit nuk është i bazuar në prova.

- 18.** Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni ka kryer një gabim aritmetik dhe logjik në lidhje me gjendjen e likuiditeteve në fund të çdo viti, pasi është marrë si gjendje pasurore edhe llogaria e biznesit të bashkëshortes. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo metodë është e gabuar sepse kjo llogari ka shërbyer për nevojat dhe likuidimet e biznesit. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në deklaratimet e tij periodike, likuiditetet janë deklaruar pa llogarinë e bashkëshortes.

**18.1** Lidhur me këtë shkak ankimi, rezultojnë se llogaria e biznesit të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në të cilën janë kryer edhe rimbursimet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (në vijim “FSDKSh”) gjendet në Raiffeisen Bank dhe mban numrin {\*\*\*}. Kjo llogari nuk është përfshirë në llogaritjet e gjendjes së likuiditeteve për subjektin e rivlerësimit dhe familjen e tij, por është analizuar për derdhjet e rimbursimeve të përfituara nga biznesi i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

**18.2** Për sa i përket analizës financiare që subjekti i rivlerësimit ka vendosur në formën e pretendimit në ankimin e tij për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012, rezultojnë se ai ka kryer një përlllogaritje të ndryshme të kursimeve të deklaruara. Subjekti i rivlerësimit edhe pse deklaron në mënyrë specifike në deklaratat periodike se ka kryer shtesa të *cash*-it vit pas viti, nuk i reflekton ato në ankimin e tij, por e konsideron vlerën e shtesës si një gjendje të vitit përkatës, duke e pretenduar këtë *cash* si të vetmin kursim të atij viti. Subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij përlllogarit një kursim më të vogël nga sa ai ka deklaruar në deklaratat vjetore përkatëse dhe, për pasojë, i rezultojnë analiza e tij me diferencë pozitive. Kolegji e konstaton këtë veprim të subjektit të rivlerësimit si një përpjekje të tij për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë likuiditetet *cash* të tij.

**18.3** Nga verifikimi i deklaratimeve periodike të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, rezultojnë se ai ka deklaruar shtesa vit pas viti të likuiditeteve *cash*, të cilat në total nga viti 2008 deri në vitin 2012, bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, duhet të ishin në vlerën 5.700.000 lekë, ndërkohë nga analiza e kryer në Kolegji rezultojnë se për vitin 2009, subjekti nuk kishte mundësi të shtonte vlerën 1.000.000 lekë të deklaruar, por vetëm vlerën 785.546,5 lekë, si rrjedhojë subjekti i rivlerësimit nuk mund të mbulonte me të ardhurat e tij shpenzimet dhe krijimin e kursimeve për vlerën -212.453,5 lekë. Për vitin 2010, subjekti i rivlerësimit nuk do të kishte mundësi të shtonte

vlerën 2000000 lekë të deklaruar, por mundësia e kursimit për këtë vit do të ishte deri në shumën 1344222,84 lekë, si rrjedhojë subjekti i rivlerësimit nuk mund të mbulonte me të ardhurat e tij shpenzimet dhe krijimin e kursimeve për vlerën -655.777,16 lekë. Për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit nuk mund të krijonte kursime në vlerën 2000000 lekë sipas deklarimit, por mundësia për kursim e këtij viti do të ishte deri në vlerën 1816635,35 lekë, si rrjedhojë subjekti i rivlerësimit nuk mund të mbulonte me të ardhurat e tij shpenzimet dhe krijimin e kursimeve për vlerën -185.343 lekë. Në total, rezulton një diferencë ndërmjet kursimit të mundshëm dhe atij të deklaruar, nga viti 2008 – 2012, në vlerën -1.304.539,08 lekë.

19. Subjekti i rivlerësimit pretendon se bashkëshortja e tij e ka hapur biznesin në vitin 2009, vit në të cilin ka deklaruar 2000000 lekë. I gjithë qarkullimi përbëhet nga shitja e ilaçeve dhe rimbursimi prej 1.266.638 lekësh është kryer në vitin 2009, ndërsa vlera prej 733.362 lekësh është rimbursuar në vitin 2010, së bashku me një paradhënie prej 400.000 lekësh nga DRSKSh-ja. Si konkluzion, në vitin 2010 janë arkëtuar nga DRSKSh-ja 5.066.181 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 4.000.000 lekë nga qarkullimi i vitit 2010, në vlerën 733.362 lekë nga qarkullimi i vitit 2009 (diferencë e paarkëtuar në vitin 2009) dhe 400.000 lekë paradhënie nga DRSKSh-ja. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo përbën edhe diferencën e konstatuar nga Komisioni.

19.1 Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezulton se nga shkresa me nr. {\*\*\*} prot., datë 15.02.2019, vërtetim i lëshuar nga FSDKSh-ja, dhe nga studimi i llogarisë së biznesit të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nuk vërtetohet pretendimi i subjektit të rivlerësimit për likuidimin me vonesë nga FSDKSh-ja për vlerat e rimbursimit apo paradhëniet për vitin pasardhës. Nuk gjendet në llogarinë bankare apo në vërtetim ndonjë gjurmë e cila të vërtetojë vonesat apo paradhëniet e pretenduara nga subjekti në rimbursimin e barnave. Nga verifikimi i dokumentacionit të përcjellë nga Komisioni, vërehet se ka një diferencë nga vërtetimi i lëshuar nga FSDKSh-ja dhe kreditimet në llogarinë bankare për vlerat e rimbursuara, por në asnjërin nga dokumentet zyrtare nuk bazohet pretendimi i subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të analizës në Kolegj, rezulton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se rimbursimet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor nuk janë kryer brenda vitit, është kontradiktor me vërtetimin e lëshuar nga institucioni i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe nga kreditimet që ky institucion ka bërë në llogarinë e biznesit të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

19.2 Në përfundim të analizës së konkluzioneve të Komisionit në funksion të këtij shkakui të ankimit, Kolegji konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe pasuritë për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012, në vlerën kumulative -1.306.517,43 lekë.

20. **Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup>, me adresë: Rruga {\*\*\*}, {\*\*\*},** Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna prej tij, si dhe deklaratën noteriale të pronarit të shoqërisë {\*\*\*}. Kjo pasuri është në pronësi të një personi tjetër dhe ky është një fakt i verifikueshëm nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Sipas subjektit të rivlerësimit, ai ka lidhur një kontratë porosie në datën 26.04.2008 për këtë apartament, për të cilin është paguar si kapar shuma prej 4.000 eurosh dhe, sipas kontratës, likuidimi i plotë i shumës do të bëhej në datën 15.05.2008. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky likuidim i kësaj shume nuk është bërë asnjëherë dhe ky apartament nuk ka kaluar asnjëherë në pronësinë e tij.

**20.1** Në pyetësoin nr. 1 të dërguar nga Komisioni, pyetjes se a ka përdorur pasuri në emër të dikujt tjetër, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur se gjatë periudhës 2014 – 2015, ka përdorur si transit, për nevoja familjare, një apartament me sip. 75 m<sup>2</sup>, në adresën rr. {\*\*\*}, pronë e shoqërisë {\*\*\*} ShPK, me administrator M. L, i cili ia ka dhënë në përdorim gjatë lëvizjeve të subjektit të rivlerësimit për rreth një vit, pa dokumentacion dhe pa deklaratë noteriale. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se te ky apartament **ka paguar vetëm energjinë elektrike dhe ujin e pijshëm**. Në vitin 2015, ky apartament i është kthyer pronarit (ndërtuesit), i cili ia ka shitur shtetasit R. F.

**20.2** Komisioni, në korrespondencën me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (në vijim “OShEE”) ka kërkuar informacion në lidhje me faturat e energjisë në emër të subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin ligjor që është depozituar pranë OShEE-së për të lidhur kontratën e energjisë elektrike në emër të tij, si dhe çdo dokument tjetër të depozituar në atë dosje. OShEE-ja, në përgjigje të kësaj kërkesë, ka depozituar pranë Komisionit dokumentacion, si formular ankesë/kërkesë, datë 17.01.2014, të plotësuar nga subjekti i rivlerësimit për ndryshim kontraktuesi nga I. R në Dritan Seci, ku si dokumentacion shoqërues i kërkesës është depozituar një kontratë porosie dhe vërtetim nga firma ndërtuese. OShEE-ja ka depozituar pranë Komisionit shkresën<sup>4</sup> me dokumentacionin bashkëlidhur, ku ndër të tjera rezulton dhe kontrata e porosisë, datë 26.04.2008, e lidhur ndërmjet shoqërisë {\*\*\*} ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit, dhe porositësit Dritan Seci, për blerjen e një apartamenti me sip. 77 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Rrugën {\*\*\*}, Tiranë. Sipas parashikimeve të kontratës, apartamenti është porositur kundrejt çmimit 50000 euro, nga të cilat kësti i parë prej 4000 eurosh paguhet me lidhjen e kësaj kontrate, kurse likuidimi total do të bëhet më datë 15.05.2008.

**20.3** Kolegji vëren se në përgjigje të pyetësoin nr. 2, të dërguar nga Komisioni lidhur me përdorimin e këtij apartamenti në periudhën 2014-2015, si dhe për marrëdhënien me shtetasin M. L, administrator i shoqërisë {\*\*\*} ShPK, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur: *Pas vitit 2013, bashkëshortja ime D. A (S.) ka pasur disa probleme shëndetësore të shtyllës kurrizore, të evidentuara pas lindjes së fëmijës sonë. Ajo është trajtuar gjatë periudhës 2014 dhe 2015 dhe ka pasur nevojë për shërbim fizioterapie. Për këtë shkak, kemi kërkuar një banesë që mund ta përdornim kryesisht për këtë qëllim. Gjatë kësaj periudhe, kam kontaktuar me shtetasin M. L, me të cilin kam lidhje shoqërore, ortak dhe administrator i shoqërisë {\*\*\*} ShPK. Me këtë shtetas kam biseduar lidhur me porositjen e një banese në një kompleks, që do fillonte të ndërtonte, pasi kishte aplikuar për leje zhvillimi në Bashkinë e Tiranës. Gjatë bisedës, kam biseduar lidhur me mundësinë e një ambienti që të mund ta përdorja përkohësisht. Kjo është edhe marrëdhënia që unë kam me shtetasin M. L. Ai kishte një apartament të lirë për ta shitur dhe që nuk e përdorte askush. Këtë apartament ai na e vuri në dispozicion me kushtin që ta përdornim derisa t'i krijohej mundësia për ta shitur. Unë, siç dhe kam sqaruar më parë, kam paguar vetëm shpenzimet për ujë dhe energji elektrike deri në momentin që apartamenti i është shitur shtetasit R. F, në datën 26.10.2015. Deri në këtë fazë të shqyrtimit administrativ, subjekti i rivlerësimit*

<sup>4</sup> Përgjigje e OShEE-së nr. {\*\*\*} prot., datë 22.02.2019.



nuk ka sqaruar në lidhje me kontratën e porosisë së lidhur për këtë apartament, të cilin pretendon se e ka përdorur për banim.

**20.4** Kolegji vëren se pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, lidhur me kontratën e porosisë që rezultoi nga dokumentacioni i dërguar nga OShEE-ja, subjekti i rivlerësimit në lidhje me konstatimin gjatë hetimit të kësaj gjetjeje sqaroi se: *Është e vërtetë se është lidhur kontrata e porosisë, datë 26.04.2008, ku kam porositur apartamentin në fjalë dhe kam paguar shumën kapar prej 4000 eurosh dhe, sipas kontratës, likuidimi i plotë i shumës do të bëhej më datë 15.05.2008. Por ky likuidim i kësaj shume nuk është bërë asnjëherë e, për rrjedhojë, ky apartament nuk ka kaluar asnjëherë në pronësinë time. [...] duke qenë se me pronarin e shoqërisë {\*\*\*} kam pasur marrëdhënie miqësore, ky i fundit në atë kohë më ka thënë se do të ndërtonte një kompleks tjetër dhe kështu kam vendosur që të mos e ble këtë apartament dhe, kur të ndërtonte kompleksin tjetër, të blija apartamentin në rrugën {\*\*\*}, {\*\*\*}, Tiranë. Në këto kushte, pronari i shoqërisë {\*\*\*} më ktheu dhe shumën kapar prej 4000 eurosh të paguar nga ana ime, veprim ky që nuk është pasqyruar formalisht, për shkak se kjo ka qenë një marrëdhënie mes miqsh dhe është neglizhuar ana formale. Për shkak të kësaj miqësie, e kam përdorur këtë apartament në vitet 2014-2015 pa qira, dhe kontrata e mësipërme është përdorur për lidhjen e kontratës së energjisë elektrike, për lehtësi administrative, pasi formalisht nuk ishte revokuar. Bashkëngjitur përgjigjeve të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar dhe deklaratën noteriale<sup>5</sup> nga shtetasi M. L.*

**20.5** Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndryshe në përgjigjet e pyetësorëve nr. 1 dhe 2, ku përsëri nuk e përmend faktin që këtë apartament e kishte porositur vetë, për të cilin kishte lidhur edhe kontratë porosie, dhe ndryshe në përgjigjet e rezultateve të hetimit, ku pranon se ka një kontratë porosie, por ky apartament nuk ka kaluar asnjëherë në pronësinë e tij. Në deklaratën noteriale të shtetasit M. L, deklarohen të njëjtat qëndrime të subjektit të rivlerësimit të mbajtura në përgjigjet e rezultateve të hetimit. Lidhur me deklaratën noteriale, mbajmë në konsideratë qëndrimet<sup>6</sup> që ka mbajtur Kolegji në çështje të ndryshme, sipas të cilave, megjithëse nuk është e pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e saj provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështetet nga provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

**20.6** Sa i përket kontratës së porosisë, nuk rezultoi të jetë deklaruar as në DIPP-në e vitit 2008 dhe as në deklaratën *vetting*, por rezultoi gjetje vetëm gjatë hetimit administrativ në Komision. Gjithashtu, në deklaratat periodike të viteve 2010 dhe 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë banimi pikërisht këtë apartament në {\*\*\*}, Tiranë, çka do të thotë se subjekti i rivlerësimit ka vazhduar ta përdorë si apartamentin e tij dhe jo vetëm në periudhën që ai

<sup>5</sup> Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe {\*\*\*} kol., datë 02.03.2019.

<sup>6</sup> Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2018 (JR), datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1; nr. 34/2019 (JR), , datë 02.12.2019, paragrafi 85.2.

pretendon (2014-2015). Në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, subjektet e deklarimit detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, ku në germën “dh” të këtij neni përfshihen si detyrime financiare ato ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ta deklaronte në DIPP-në e vitit 2008 kontratën e porosisë, shlyerjen prej 4000 eurosh sipas mënyrës së pagesës së përcaktuar në kontratën e porosisë, si dhe detyrimin financiar që i kishte shoqërisë së ndërtimit për vlerën prej 46000 eurosh, të mbetur nga totali i vlerës së apartamentit (50.000 euro).

**20.7** Kolegji vëren se në kontratën e porosisë, datë 26.04.2008, të sjellë në Komision nga OShEE-ja, të lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë {\*\*\*} ShPK, objekt i kontratës është apartament banimi me sip. 77 m<sup>2</sup>, ambient i pozicionuar **në katin e 2-të të pallatit, me orientim nga perëndimi**, i ndodhur në Rrugën {\*\*\*}, {\*\*\*}. Kjo është banesa që, nga përgjigjet e subjektit të rivlerësimit në Komision, ka pranuar se ka banuar për periudhën 2014-2015, dhe më pas, sipas subjektit të rivlerësimit, të njëjtën banesë e ka blerë shtetasi R. F në vitin 2015. Nga kontrata e porosisë me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 26.10.2015, të cilën e ka dërguar në Komision subjekti i rivlerësimit, kontratë e lidhur ndërmjet shoqërisë {\*\*\*} dhe R. F., objekt kontrate është **apartament në Rrugën {\*\*\*}, me sip. 77 m<sup>2</sup>, ndodhur në katin e 4-t të pallatit, me orientim nga veriperëndimi**, i cili shkëmbehet me një sipërfaqe banimi prej 107 m<sup>2</sup>, i ndodhur në rrugën {\*\*\*} {\*\*\*}, objekt i ri të cilin sipërmarrësi {\*\*\*} po e ndërton në pronën e porositësit (R. F). Në lejen zhvillimore të ndërtimit me nr. {\*\*\*}prot., datë 10.10.2014, miratuar nga Bashkia Tiranë, citohet se i jepet zhvilluesit {\*\*\*} ShPK për “Kompleks banimi dhe shërbimesh 1, 4, 6 dhe 8 kate, me 1 dhe 2 kate nëntokë”, në pronë të [...] dhe R. F”. Pra, rezulton që ky i fundit ka shkëmbyer sipërfaqen (107 m<sup>2</sup>) që ka në pronësi të tij në {\*\*\*}, tek e cila po ndërtonte shoqëria {\*\*\*}, me një apartament në Rrugën {\*\*\*} të ndërtuar po nga kjo shoqëri, por që nga detajimi i të dhënave të pronës në kontratën e sipërmarrjes, edhe pse duket e njëjta sipërfaqe ndërtimi, nuk rezulton të jetë i njëjtë pozicioni gjeografik i apartamentit ku ka banuar subjekti i rivlerësimit dhe kati i apartamentit për të cilin pretendohet se e ka blerë R. F.

**20.8** Kolegji vëren se në të dyja këto kontrata, si objekt porosisë (kontrata e subjektit të rivlerësimit) dhe shkëmbimi (kontrata e R. F.) trajtohen apartamente të ndryshme, ku apartamenti ku ka banuar subjekti i rivlerësimit është në katin e 2-të me orientim nga perëndimi, ndërsa ai që ka shkëmbyer R. F. me shoqërinë {\*\*\*} është në katin e 4-t, me orientim nga veriperëndimi, pra janë të pozicionuara në plane të ndryshme dhe në krahë të ndryshëm, çka e bën të pabesueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit se apartamentin e tij e ka blerë R. F, pasi në kontratën e sipërmarrjes së këtij të fundit rezulton apartament tjetër, edhe pse në të njëjtin kompleks apartamentesh në {\*\*\*}, Tiranë. Ndërkohë, në kontratën e sipërmarrjes me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 14.07.2015, të lidhur ndërmjet shoqërisë ndërtuese {\*\*\*} ShPK dhe

subjektit të rivlerësimit, të dhënat e pronës ku do të ndërtohej apartamenti objekt kontrate, si vendndodhja (rr. {\*\*\*}, {\*\*\*}) dhe sipërfaqja (me sip. 107 m<sup>2</sup>), janë në dukje të njëjtat me të dhënat e pronës që ka shkëmbyer R. F., ku hiqte dorë nga sipërfaqja të cilën e kishte në pronën e tij (me sip. 107 m<sup>2</sup>), për ta shkëmbyer me apartamentin (me sip. 77 m<sup>2</sup>) në {\*\*\*}. Tërësia e këtyre veprimeve të rezultuara dhe dokumentacioni i administruar në dosje, nuk mbështesin pretendimet e subjektit të rivlerësimit se kontrata e sipërmarrjes nuk ka dhënë efekte juridike dhe apartamentin në {\*\*\*} e ka përdorur vetëm për banim në periudhën 2014-2015.

**20.9** Në parashtrimet e datës 18.11.2020 të dorëzuara në Kolegj, subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë shkak ankimi ka sqaruar: *Kontrata ku kam paguar kaparin nuk ka qenë e realizuar para noterit, ndaj kjo është arsyeja pse nuk është revokuar, pasi ka munguar ana formale. Kontratat, në kuptim të Kodit Civil shqiptar, për kontratat e pasurive të paluajtshme, forma e veprimit juridik është element thelbësor dhe, nëse kontratat që kanë të bëjnë me pasuri të paluajtshme duhet të bëhen para noterit, mungesa e këtij elementi sjell pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik, pra ky veprim nuk sjell asnjë pasojë. Në këto kushte, revokimi i kontratës ka qenë juridikisht i panevojshëm, pasi për shkak të mungesës së formës, ky veprim ka qenë i pavlefshëm dhe nuk mund të sillte pasoja. Kjo kontratë, për shkak se nuk është lidhur para noterit, nuk mund të regjistrohej në ZVRPP, pasi nuk plotësonte kushtet për t'u regjistruar. Për këtë arsye, është neglizhuar edhe revokimi i saj se pasoja ishte nul.*

**20.10** Kolegji vëren se ky është një qëndrim tjetër nga sa ka mbajtur subjekti i rivlerësimit në Komision, në përgjigje të pyetësorëve për këtë pasuri, si dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit të cituara më sipër. Qëndrimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë të ndryshme si në Komision, ashtu dhe në Kolegj. Fillimisht subjekti i rivlerësimit në pyetësorin standard të Komisionit ka thënë se M. L ia kishte dhënë në përdorim apartamentin, pa ekspozuar kontratën e porosisë me shoqërinë e ndërtimit {\*\*\*} ShPK. Kjo kontratë rezultoi vetëm pas korrespondencës së Komisionit me OShEE-në, ku kjo e fundit e ka sjellë si dokumentacion mbi të cilin ka bazuar hapjen e kontratës për furnizim me energji elektrike me subjektin e rivlerësimit. Më tej, i pyetur dhe i vënë në dijeni nga Komisioni, pasi nga hetimi administrativ kryesisht ka rezultuar një kontratë sipërmarrjeje për apartamentin e përdorur, subjekti i rivlerësimit e pranon që ka një kontratë, por jo që ky apartament ka kaluar në pronësi të tij, pasi sipas tij do të ndërtohej një tjetër kompleks në {\*\*\*}, Tiranë, ku do të porosiste një apartament tjetër, thotë subjekti i rivlerësimit. Pra, siç vërehet, qëndrimet e ndryshme të subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, bëjnë që shpjegimet dhe përgjigjet e tij të jenë të pabesueshme dhe jobindëse, kjo e mbështetur edhe me dokumente dhe rrethana të tjera të rezultuara gjatë shqyrtimit administrativ në Komision dhe atij gjyqësor në Kolegj, çka e bën evident faktin se subjekti i rivlerësimit përpiqet të manipulojë të vërtetën.

**20.11** Në analizë të rrethanave faktike që u cituan më lart, del qartë fakti se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* kontratën e porosisë së lidhur në vitin 2008 me shoqërinë {\*\*\*}, që duhet parë e konsideruar në raport me deklaratimet dhe mosdeklarimet e

pasurisë në vite të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me këtë pasuri. Fakti i mosdeklarimit në deklaratën *vetting*, është paraprirë nga mungesa e deklarimit të porositjes së apartamentit në vitin 2008, në kundërshtim me detyrimin e subjektit të rivlerësimit për deklarim sipas ligjit, vit në të cilin subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë me diferenca negative në drejtim të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e fituara në atë vit. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se nëse i përllogaritet vlera e paguar si kapar në vitin 2008, subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të përballonte shpenzimet e këtij viti dhe gjithashtu të krijonte kursimet e deklaruara. Në vijim të kësaj situatë, Kolegji konstaton se mosdeklarimi i kontratës së porosisë për këtë apartament në deklaratën *vetting*, në këndvështrim të gjithë përshkrimit të mësipërm, jo vetëm e bën të pabesueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ai nuk e deklaruar këtë kontratë për faktin se prona nuk posedohej prej tij, por e konsideron këtë sjellje të subjektit të rivlerësimit në funksion të mbulimit të ndonjë situatë të dyshimtë. Për pasojë, deklaratimet e shpjegimet që bën subjekti i rivlerësimit në lidhje me pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup>, me adresë Rruga {\*\*\*}, {\*\*\*}, nga Kolegji konsiderohen se tentojnë të fshehin të vërtetën.

*20.12 Në përfundim të analizës së konkluzioneve të Komisionit për shkak të shkaqeve të ankimit si më sipër, lidhur me deklarimin e apartamentit të porositur sipas kontratës së porosisë, Kolegjit i rezulton se në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë pasurinë apartament banimi dhe, si rrjedhojë, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, çmohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje pasurie.*

- 21. Lidhur me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 11.03.2014, të shtetasit B. M,** i cili deklaron se i jep mikut të tij Dritan Seci, shumën prej 20.000 eurosh, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se me shtetasin B. M nuk ka asnjë njohje dhe asnjë kontakt. Deklarata e bërë nga ana e tij është e njëanshme dhe nuk provon në asnjë situatë marrjen nga ai shumën e pretenduar në këtë deklaratë. Sipas kësaj logjike, çdokush mund të bëjë një deklaratë të tillë dhe të mund të vendosë çdo lloj shume, por kjo kurrsesi nuk mund të provojë faktin se diçka e tillë ka ndodhur vërtet. Që kjo marrëdhënie e pretenduar nga shtetasi në fjalë, të ketë vlerë ligjore, subjekti i rivlerësimit pretendon se do të duhej që ta pranonte një dhuratë të tillë nga ky shtetas, pasi dhe vetë Kodi Civil, neni 761, e ka përcaktuar se në marrëdhënien juridike të dhurimit pala tjetër duhet të shprehet se e pranon dhuratën. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka pranuar këtë marrëdhënie juridike dhe as e njeh shtetasin deklarues dhe se po shqyrton mundësinë e një kallëzimi penal apo padie civile për shpifje, pasi deklaratimet janë krejtësisht të pavërteta.

**21.1** Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, me shkresën e saj nr. {\*\*\*} prot., datë 10.05.2017, drejtuar ILDKPKI-së, konfirmon se në emër të shtetasit Dritan Seci ka raportime të veprimeve noteriale, dhe konkretisht të deklaratës noteriale të cituar në paragrafin më sipër, të hartuar përpara noteres E. L., nga shtetasi B. M, ku shuma e përfshirë në transaksion është 20.000 euro.

**21.2** Në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.03.2014, dërguar nga ana e noteres E. L., Tropojë, në adresë të ILDKPKI-së, rezulton se Dritan Seci është përfitues i shumës prej 20.000 eurosh, dhënë nga shtetasi B. M, i cili deklaron se këtë shumë ia jep mikut të tij,

subjektit të rivlerësimit, pa kundërshtpërblim dhe pa kthim, për nevoja familjare. Në deklaratat e subjektit të rivlerësimit nuk rezultojnë të jetë deklaruar kjo shumë e dhuruar, as në DIPP-në e vitit 2014 dhe as në deklaratën *vetting*.

**21.3** Kolegji vëren se ILDKPKI-ja në aktin e kontrollit të plotë me nr. {\*\*\*}, datë 22.01.2018, lidhur me këtë fakt, ka konkluduar se: “Rezultojnë se është fshehur nga ana e subjektit të rivlerësimit deklarata noteriale nr. {\*\*\*/{\*\*\*}}, dt. 11.03.2014, për përfitimin e vlerës 20000 euro, nga shtetasi B. M, si në DIPP-në e vitit 2014, ashtu dhe në deklaratën *vetting*. Gjithashtu është fshehur qëllimi dhe destinacioni i vlerës 20000 euro”.

**21.4** Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit në pyetësin nr. 4, datë 25.01.2019, në lidhje me njohjen rreth këtij personi, arsyet pse nuk është deklaruar kjo shumë, si dhe për shpenzimet dhe investimet e kryera prej tij. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit, ka sqaruar në mënyrë të përmbledhur se: *Lidhur me deklaratën noteriale me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.03.2014, menjëherë pas marrjes së pyetësorit jam interesuar pranë noterit E. L. për të marrë një kopje të këtij akti noterial. Kjo deklaratë noteriale nuk ka asnjë lidhje me mua personalisht, pasi nuk kam asnjë njohje me shtetasin B. M, që sipas të dhënave në aktin noterial është shtetas anglez, pasi ka bashkëlidhur edhe kopje të pasaportës së Mbretërisë së Bashkuar, lindur në Morinë Kosovë. Subjekti i rivlerësimit sqaron se nuk është miku i tij, siç është shprehur ai në aktin noterial dhe nuk ka asnjë lidhje me shumën prej 20000 eurosh, të cilën nuk e ka marrë, ndaj nuk e ka deklaruar, sqaron subjekti. Ky i fundit deklaroi se këtë shtetas nuk e ka takuar asnjëherë në jetën e tij, e jo më të ketë marrë prej tij shumën e cituar në këtë deklaratë.*

**21.5** Nga verifikimet e kryera nga Komisioni në sistemin TIMS për subjektin e rivlerësimit Dritan Seci në lidhje me hyrje-daljet e tij nga territori shqiptar, subjekti dhe B. M kanë përdorur automjetin e vëllait të subjektit në mënyrë të alternuar me B. M. dhe në një distancë kohore prej 48 orësh. Rezultojnë se subjekti e ka përdorur këtë mjet në raste të ndryshme në vitet 2014, 2015, si dhe në vitin 2016, pak ditë pasi e ka përdorur edhe B. M. Këto rrethana faktike e bëjnë pretendimin e subjektit të rivlerësimit, për mungesë njohjeje me B. M. jobindës. Po nga sistemi TIMS që u përket lëvizjeve me hyrje-daljet e subjektit të rivlerësimit, rezultojnë se ka shumë hyrje-dalje në vitet 2014, 2015 dhe 2016 me të njëjtin automjet, me targën e sipërcituar. Nga rezultatet e këtij verifikimi, përjashtohet si i mundshëm pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ai nuk ka asnjë lidhje me personin deklarues, nuk ka asnjë njohje, nuk është miku i tij dhe nuk ka asnjë lidhje me shumën prej 20000 eurosh, referuar deklaratës noteriale të nënshkruar nga B. M, pasi nga verifikimi i mësipërm rezultojnë se me të njëjtin automjet që ka udhëtuar subjekti i rivlerësimit, ka udhëtuar edhe B. M, automjet në pronësi të vëllait të subjektit të rivlerësimit. Rrethana faktike këto sa më sipër, që Kolegjit i krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit e njihet B. M. dhe se ishte në dijeni të deklaratës noteriale të këtij të fundit për dhënien ndihmë dhe pa kthim të shumës prej 20000 eurosh, duke e pranuar në heshtje këtë ndihmë.

**21.6** Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni në lidhje me mosdeklarimin e fakteve të parashtruara më sipër, për mohimin e njohjes me shtetasin B. M, si dhe mohimin e përfitimit të shumës prej 20000 eurosh nga ky i fundit, ka sqaruar: *[...] Ju sqaroj edhe një herë se me shtetasin B. M nuk kam asnjë njohje dhe asnjë kontakt. Deklarata e bërë nga ana e tij është e njëanshme dhe nuk provon në asnjë situatë se unë kam marrë nga ai shumën e pretenduar në këtë deklaratë. Sipas logjikës së kësaj deklarate, çdokush mund të bëjë një deklaratë të tillë, mund të vendosë çfarëdolloj shume, por kjo kurrsesi nuk mund të provojë faktin se një gjë e tillë ka ndodhur vërtet. Në mënyrë hipotetike, një gjë e tillë mund t'i ndodhë kujt do,*

*edhe juve të nderuar anëtarë të Komisionit, ku një i panjohur mund të deklarojë para noterit se ju ka dhënë këtë apo atë shumë pa dijeninë tuaj. Në lidhje me faktin se personi në fjalë rezulton të ketë udhëtuar me automjetin me targë {\*\*\*}, në pronësi të vëllait tim, i cili është përdorur nga ana ime, ju sqarojmë se më rezulton se ky automjet, përveç meje, është përdorur edhe nga persona të tjerë, të cilët janë shtetasit A. S. sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., A. C. sipas kontratës për përdorim mjete nr. {\*\*\*} rep., datë 02.10.2011, shtetasi A. M. sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., kontrata të cilat po jua dërgojmë bashkëngjitur. Ju sqaroj edhe një herë se nuk i di rrethanat në të cilat ky shtetas ka udhëtuar në makinën e vëllait tim, të cilën e kam përdorur edhe unë, dhe as arsyet e rrethanat se përse ai e ka bërë një deklaram të tillë. Jam i gatshëm në çdo kohë dhe kërkoj të ballafaqohem me këtë shtetas në lidhje me këto deklarime të pavërteta, të bëra nga ana e tij në adresën time.*

**21.7** Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, Komisioni, në korrespondencën me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe me prokurorinë pranë kësaj gjykate, ka pyetur nëse shtetasi B. M ka pasur çështje civile apo penale në këto dy institucione, për të vërtetuar situatë konflikti të mundshëm interesi apo lidhje të këtij shtetasi me subjektin Dritan Seci në pozicionin e gjyqtarit. Nga shkresat<sup>7</sup> e kthyera nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, si dhe nga prokuroria pranë kësaj gjykate, është kthyer përgjigje se nuk disponohen të dhëna në lidhje me vendim penal apo civil, apo vendime të prokurorisë në lidhje me këtë shtetas.

**21.8** Komisioni i ka kërkuar shpjegime edhe noteres në lidhje me deklaratën noteriale të nënshkruar nga shtetasi B. M. Në përgjigjen e saj me nr. {\*\*\*} prot., datë 09.02.2019, notere E. L., ndër të tjera, ka deklaruar: [...] në datën 11.03.2014, është paraqitur personalisht shtetasi B. M [...] Me kërkesën dhe prezencën e tij, shtetasi B. M ka kërkuar vetëdeklarimin e deklaratës noteriale, duke qenë gjithë kohën prezent në zyrë dhe duke deklaruar vetë personalisht me zë/me fjalët e tij, nuk ka pasur diçka të shkruar, për përmbajtjen e deklaratës noteriale si më poshtë: “Unë, deklaruesi B. M, me vullnet të lirë dhe të plotë, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë, deklaroj se nga të ardhurat e mia personale nga puna, i kam dhënë në formë ndihme, mikut tim, z. Dritan Seci, shumën prej 20000 (njëzet mijë) eurosh, në janar të vitit 2014. Kjo vlerë i jepet mikut tim Dritan Seci, pa kundërshtpërblim dhe pa kthim, për t’i përdorur për nevojat e tij familjare”. Gjatë redaktimit të deklaratës noteriale, është pyetur nga ana ime (meqenëse deklarata ishte e njëanshme), se për cilin shtetas bëhet fjalë, ku më është konfirmuar nga deklaruesi se është miku im Dritan M. Seci, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Nga noterja është raportuar deklarata noteriale në Drejtorinë e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, duke e deklaruar subjektin e rivlerësimit me emër, mbiemër dhe atësi, institucionin ku punon (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë), si dhe shumën (20.000 euro) e dhënë në formë ndihme nga deklaruesi B. M.

**21.9** Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e dorëzuara në Kolegj, më datë 18.11.2020, është shprehur se: *Ju sqaroj se lidhur me këtë shtetas tashmë kam bërë kallëzim penal për veprat penale të “falsifikimit të dokumenteve” dhe “shpifjes”, gjë që provohet nga shkresa me nr. {\*\*\*}prot., datë 13.11.2020, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Bajram Curri, ku vihem në dijeni se materiali kallëzues ndodhet në fazën e hetimit paraprak dhe do vihemi në dijeni për vendimmarrjen e mëtejshme të organit të akuzës. Personin në fjalë as e njoh dhe as e kam njohur ndonjëherë, prandaj dhe kam kërkuar të ndiqet penalisht. Subjekti i rivlerësimit u ka*

---

<sup>7</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 04.02.2019; shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 04.02.2019.

bashkëngjitur parashtrimeve dhe kallëzimin e bërë ndaj këtij shtetasi, i cili është protokolluar nga Prokuroria e Bajram Currit me nr. {\*\*\*}, datë 19.10.2020.

**21.10** Kolegji vëren se deklarata noteriale është hartuar në vitin 2014, vit ky i pavesuar nga procesi i rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit, ndërsa deklaratimet në ILDKPKI janë vijuese dhe të përvitshme, çka detyrojnë dhe mundësojnë evidentimin e çdo transaksioni të kryer nga subjektet ose të kryer në favor të tyre. Neni 761 i Kodit Civil, që referon në ankim subjekti i rivlerësimit, parashikon: *Dhurimi është kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi, pa shpërblim, palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale, të cilat ajo i pranon.* Nisur nga ky parashikim, pala që pranon dhurimin duhet patjetër të shprehë vullnetin sipas nenit<sup>8</sup> 80, paragrafi i parë i Kodit Civil, për pranimin e dhurimit. Në nenin 764, paragrafi i tretë i Kodit Civil, parashikohet: *Në qoftë se ka për objekt sende të luajtshme, ai është i vlefshëm kur ato specifikohen duke treguar edhe vleftën e tyre në kontratën e dhurimit.* Sipas këtij parashikimi ligjor, edhe për sendet e luajtshme kontrata e dhurimit është e vlefshme, me kusht që të përcaktohet vlera e tyre. Nga ana tjetër, referuar rastit konkret, kontrata e dhurimit e shoqëruar edhe me dhënien e pëlqimit për pranimin e dhurimit, në formën e shkruar, do të sillte për subjektin e rivlerësimit lindjen e detyrimit për deklarimin e saj në deklaratat periodike vjetore, bashkë me burimin e krijimit të saj. Si rrjedhojë, fakti i dokumentimit të kësaj shume me veprim juridik të njëanshëm, kryer në këtë formë, i ka lejuar subjektit të rivlerësimit të shmangë dokumentimin e dhurimit dhe pranimin nga ana e tij e, në këtë mënyrë, edhe detyrimet për ta deklaruar ndër vite. Kjo mënyrë duket edhe si një përpjekje për të shmangur përgjegjësinë apo dhënien e shpjegimeve për arsyet që qëndrojnë në themel të këtij dhurimi. Rrjedhimisht dhe logjikshëm, arsyetohet se deklaratimet e shpjegimet që bën subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë fakt, konsiderohen se tentojnë të fshehin të vërtetën.

**21.11** Kolegji vlerësoi se përgjigjet dhe shpjegimet që ka dhënë subjekti i rivlerësimit gjatë procesit administrativ, vijnë në kundërshtim me dokumentacionin e administruar në dosje. Pavarësisht se subjekti deklaroi se nuk e njej shtetasin dhurues të shumës 20.000 euro, nga dokumentacioni i ekstraktuar nga sistemi TIMS, rezultoi se si subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe B. M. kishin udhëtuar nga Shqipëria në drejtim të Kosovës, në të njëjtën pikë kufitare Qafë Morinë. Kalimi i kufirit është bërë me të njëjtin automjet, i cili rezultoi në pronësi të vëllait të subjektit të rivlerësimit, për një segment kohor me diferencë prej dy ditësh, tërësi rrethanash këto, të cilat të çojnë në mospranimin e pretendimit të subjektit të rivlerësimit se nuk ka njohje me dhuruesin e shumës. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit është vënë në dijeni nga Komisioni që në momentin e kalimit të barrës së provës për deklaratën e shtetasit B. M., fakti i cili mund të ndikojë në vendimmarrjen në procesin e rivlerësimit, si rrjedhojë edhe në karrierën e subjektit të rivlerësimit dhe ky i fundit, megjithëse është shprehur në ankim se po shqyrton mundësinë për një kallëzim në prokurori për B. M., këtë e ka realizuar vetëm pak ditë përpara fillimit të gjyqimit të çështjes në Kolegj. Kjo tregon qartësisht se subjekti i rivlerësimit nuk ka dashur që kjo çështje të marrë zgjidhje dhe të merret vendim nga prokuroria përpara shqyrtimit të çështjes së subjektit të rivlerësimit në Kolegj, por të dokumentojë vetëm faktin e dorëzimit të kallëzimit penal për efekt të këtij procesi, çka e bën subjektin e rivlerësimit jobindës për qëndrimet që ka mbajtur. Për më tepër, provat që ka paraqitur lidhur me rrethanat e kësaj nënçështjeje si në Komision, ashtu edhe në Kolegj, të krijojnë bindjen e një përpjekje të tij për të fshehur pasurinë.

---

<sup>8</sup> “Veprimi juridik mund të kryhet me shkrim, me gojë dhe me çdolloj shfaqje tjetër të padyshimit të vullnetit.” [..]

**21.12** Në përfundim të analizës së konkluzioneve të Komisionit për shkak të shkaqeve të ankimit lidhur me mosdeklarimin e shumës 20000 euro, Kolegjit i rezultoi se në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë pasurinë/likuiditet në shumën 20000 euro dhe, si rrjedhojë, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, çmohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje pasurie.

**22.** **Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 74 m<sup>2</sup>, ndodhur në Bajram Curri, pasuri në bashkëpronësi të bashkëshortes së subjektit me prindërit e saj,** subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se kjo pasuri është blerë nga prindërit e bashkëshortes kur subjekti i rivlerësimit ende nuk ishte martuar me të dhe se bashkëshortja e tij nuk ka pasur dijeni se është bashkëpronare dhe nuk e ka informuar subjektin në lidhje me këtë fakt. Pasi janë informuar nga prindërit e bashkëshortes, në deklaratën noteriale të datës 06.09.2018, bashkëshortja ka hequr dorë nga bashkëpronësia e kësaj pasurie dhe për këtë janë kryer edhe ndryshimet përkatëse në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në Bajram Curri.

**22.1** Në përgjigje të shkresës së dërguar nga Komisioni, ZVRPP-ja Tropojë ka vënë në dispozicion dhe informacionin në lidhje me pasuritë e paluajtshme të shtetasit H. A., babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

Nga ky informacion dhe dokumentacioni i përcjellë nga ZVRPP Tropojë, ka rezultuar se në emër të D. A., F. A. dhe H. A. është regjistruar pranë kësaj zyre pasuria apartament me sip. 74 m<sup>2</sup>, me adresë B. Curri, me nr. pasurie {\*\*\*}. Ky apartament është përfituar nga kontrata e shitblerjes me nr. {\*\*\*} prot., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 29.01.2002, ndërmjet shitësve D., Gj., S. dhe I. R. dhe blerësve H., F. dhe D. A., me çmimin 350000 lekë.

**22.2** Nga ana e subjektit të rivlerësimit, si dhe e personit të lidhur me të, bashkëshortes së tij, znj. D. A., nuk rezulton e deklaruar pjesa takuese prej 1/3 të apartamentit në bashkëpronësi me prindërit e saj, në deklaratën periodike të vitit 2012, vit që bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit i ka lindur detyrimi për të deklaruar pasuritë më vete, si dhe nuk rezulton e deklaruar as në deklaratën *vetting*.

**22.3** Pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Kjo pasuri është blerë nga prindërit e bashkëshortes në kohën që unë nuk isha i martuar me të dhe as ajo nuk ka pasur dijeni se është bashkëpronare dhe nuk më ka informuar për këtë fakt. Pasi jemi informuar nga prindërit e bashkëshortes në lidhje me këtë fakt, me deklaratën noteriale të datës 06.09.2018, bashkëshortja ka hequr dorë nga bashkëpronësia në këtë pasuri dhe është bërë ndryshimi i pronësisë në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.*

**22.4** Kolegji vëren se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, nuk ka deklaruar pasurinë e saj, apartamentin në bashkëpronësi me prindërit. Neni D, pikat 1, 2 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pika 7 e Udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarimin saktësisht dhe mjaftueshmërisht të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me burimin në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast përfshihet si origjina, pra shkak apo veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, ashtu dhe mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj.



22.5 Në këto rrethana faktike, Kolegji vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë për kriterin e pasurisë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit D, paragrafët 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Meqenëse vlerësohet se kjo pasaktësi nuk ka pasur si qëllim mbulimin e ndonjë situatë të dyshimtë, si dhe nga ana tjetër nuk vihet në dyshim burimi i krijimit të pasurisë dhe, nëse një pasaktësi e tillë do ishte e vetme në deklarimin e subjektit të rivlerësimit, ajo nuk do të sillte automatikisht shkarkimin e tij nga detyra, Kolegji, rrethanat e kësaj pasaktësie vlerësoi të mos i ngrinte në nivelin e një shkaku shkarkimi.

23. **a. Lidhur me konstatimin e Komisionit për automjetin autoveturë, tip “Volksvagen Golf”,** me targë {\*\*\*}, deklaruar në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2004, me vlerën 250.000 lekë, Komisioni ka arritur në konkluzionin e pasqyruar në faqe nr. 21 të vendimit të tij, se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë: *i) të çmimit të blerjes së automjetit; ii) të automjetit në deklaratën periodike vjetore të pasurisë të vitit 2004, ndërkohë që automjeti rezultoi i blerë më datë 19.02.2005.*

**b. Lidhur me përdorimin e automjetit të tipit “Opel Vectra”,** me vit prodhimi 1990, me targa {\*\*\*}, në pronësi të shtetasit A. S., si dhe të automjetit të tipit “Daimler Chrysler” (Mercedes-Benz) i tipit C250, me vit prodhimi 1998, me targë {\*\*\*}, me pronar A. S., Komisioni ka arritur në konkluzionin e pasqyruar në faqen nr. 22 të vendimit të tij, se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, në lidhje me faktin e përdorimit nga ana e tij të dy automjeteve me të dhënat e mësipërme, përkatësisht me targat {\*\*\*} dhe {\*\*\*}.

23.1 Subjekti i rivlerësimit lidhur me këto konkluzione të Komisionit nuk ka ngritur shkaqe ankimi, si rrjedhojë, rezultatet e këtyre dy çështjeve (**a**, **b**, si më sipër) që janë trajtuar me konkluzionet përkatëse në Komision, mbeten të pandryshuara, për shkak të moskundërshtimit në ankim nga ana e subjektit të rivlerësimit.

24. Megjithëse disa prej shkaqeve të ankimit, të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit e të analizuar nga trupi gjykues i Kolegjit, rezultuan të bazuara, ato u vlerësuan prej tij si të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.

25. Kolegji, bazuar në përfundimet e mësipërme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si rrjedhojë vendimi i Komisionit nr. 114, datë 11.03.2019, duhet lënë në fuqi, pasi gjendet i drejtë e i bazuar në fakte, prova dhe ligj.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, bazuar në aktet e administruara në dosjen e përcjellë nga Komisioni dhe në legjislacionin e zbatueshëm, arriti në përfundimet e mëposhtme.

- I. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të rezultuan se kanë mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar shpenzimet dhe pasuritë për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- II. Në lidhje me pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup> me adresë Rruga {\*\*\*}, {\*\*\*}, Tiranë, Kolegji arriti në konkluzionin se ky apartament është pasuri e subjektit të

rivlerësimit dhe është kryer fshehje pasurie në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

- III. Në lidhje me deklaratën noteriale të shtetasit B. M për shumën prej 20.000 euro që ia ka dhënë subjektit të rivlerësimit pa kundërshpërblim dhe pa kthim, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje pasurie në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 114, datë 11.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Seci.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.  
U shpall sot, më datë 24.11.2020, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

## MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, jam dakord me vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), për lënien në fuqi të vendimit nr. 114, datë 11.03.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Seci.
2. Në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*\*} kol., datë 11.03.2014, mbajtur përpara noteres E. L., Tropojë, shtetasi B. M. deklaroi t’i ketë dhënë subjektit të rivlerësimit Dritan Seci, shumën prej 20000 eurosh pa kundërshtim dhe pa kthim, për nevoja familjare.
3. Noterja E. L., pas formulimit të këtij akti noterial, ka raportuar pranë Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave, konkretisht gjeneralitetet e subjektit të rivlerësimit (emër, atësi, mbiemër), institucionin ku punon (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë), si dhe shumën 20000 euro.
4. Me shkresën e saj nr. {\*\*\*}prot., datë 10.05.2017, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave informon ILDKPKI-në se në emër të shtetasit Dritan Seci ka raportime të veprimeve noteriale, hartuar përpara noteres E. L., Tropojë, për dhënien e shumës 20000 euro nga shtetasi B. M.
5. Lidhur me këtë deklaratë noteriale, shumica e trupit gjykues ka vendosur:

*[...]Kolegjit i rezultoi se në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë pasurinë/likuiditet në shumën 20000 euro dhe, si rrjedhojë, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, çmohet se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje pasurie.*

6. Ndryshe nga sa arsyeton shumica e trupit gjykues, nisur nga fakti që vetë shtetasi B. M. deklaroi në deklaratën objekt shqyrtimi se shuma 20000 euro i është dhënë Dritan Secit *pa kundërshtim dhe pa kthim*, çmohet se ndodhemi në kushtet e shprehjes së vullnetit të njëanshëm të deklaruesit B. M.
7. Për këtë veprim duhet domosdoshmërisht dhënia e pëlqimit nga ana e përfituesit/subjektit të rivlerësimit, gjë që do ta bënte këtë veprim juridik të vlefshëm. Është i rëndësishëm fakti që përfituesi duhet në çdo lloj forme të shprehë pëlqimin e tij, gjë të cilën nuk e kemi hasur përgjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegji. Dhurimi duhet të jetë real dhe duhet domosdoshmërisht dorëzimi i sendit/shumës dhe dhënia e pëlqimit të përfituesit për të pranuar atë. Duke qenë para faktit të mungesës së këtij elementi bazë të institutit të dhurimit, pëlqimin e përfituesit, çmohet se jemi përpara një veprimi juridik të pavlefshëm dhe formulimi i një akti të tillë, referuar dhe vlerës së këtij deklarimi, nuk duhet të ishte pranuar nga noterja në këtë formë. Efektet e ligjshme të këtij deklarimi nuk mund të konsiderohen pa dhënien e pëlqimit nga ana e përfituesit/subjektit të rivlerësimit Dritan Seci.
8. Arsyetimin e mësipërm e përforcon fakti i mungesës së provave shkresore të marrjes së kësaj shume nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në dosjen gjyqësore nuk gjendet e administruar asnjë transfertë bankare, asnjë akt zyrtar apo jozyrtar, që mund të provojë se subjekti ka marrë këtë shumë.

9. Gjithashtu nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit ta ketë përdorur këtë shumë si burim për krijimin e ndonjë pasurie përgjatë periudhës së rivlerësimit. Nuk është deklaruar asnjëherë prej tij as në deklaratat periodike të interesave privatë dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*. Asnjë provë tjetër në fashikullin e gjykimit nuk është në harmoni me këtë deklaratë noteriale për të krijuar bindjen se me të vërtetë subjekti i rivlerësimit mund të ketë përfituar shumën prej 20000 eurosh.
10. Nga hetimi i kryer nga Komisioni dhe nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes në Kolegj, nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë në kushtet e ndonjë konflikti interesi me shtetasin B. M.
11. Fakti se gjatë redaktimit të deklaratës noteriale, është pyetur nga ana e noteres deklaruesi (meqenëse deklarata ishte e njëanshme) se për cilin shtetas bëhet fjalë dhënia e kësaj shume, ai është përgjigjur se *është miku im Dritan M. Seci, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë*, të krijoj bindjen se ky deklaram mund të jetë edhe i qëllimshëm.
12. Vlerësoj të rëndësishëm faktin që gjykata në momentin e vendimmarrjes duhet të përdorë argumente bindëse për të vlerësuar faktin juridik dhe, në rastin konkret, argumentet nuk provojnë që subjekti i rivlerësimit Dritan Seci të ketë marrë shumën prej 20.000 eurosh, sipas deklaratës noteriale të shtetasit B. M.

**Gjyqtare**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*